10.3	Vendosja e një mekanizmi për monitorimin dhe raportim të komunave për zbatimin e Planeve Komunale të Ri integritit dhe integritit të qëndrueshëm.	Raportimi të DRPRIH për zbatim të planit Raportimi të MAPL Për zbatim të planit	Mekanizmi për monitorim dhe raportim të zbatimit të planit komunal për rintegrim dhe integrim të qëndrueshëm të personave të riaidhesuar dhe te huaj	ZKKK	Drejtorië përkatëse komunale MAPL DRPRIH/MPB QPS ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus rintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	Në vazhdimësi	Raporti i zbatimit të planit komunal



P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **30.3.2023 (e enjte)**, me fillim në orën **11:30**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **Defrim Kafexhiu**. Në fillim konstatoi se ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Para se të fillojmë, i lus të gjithë të ngritemi në këmbë dhe të nderojmë të rënët e muajit mars me një minut heshjte.

I nderuar Kryetar i Komunës, **Smajl Latifi**, Nënkyetar z. **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit! Kjo është seanca e tretë (3) për këtë vit kalendarik. Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars, për këtë seancë, ka përgatitur këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për faljen e borxheve të papaguara për taksat në aktivitete (afariste), nga data 1.1.2000 – 31.1.2017;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.149/2006, i datës 14.7.2006;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-71510057-05539-0 - zona kadastrale Rahovec;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike me pronën e Institucionit Qendror – zona kadastrale Rahovec;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për riparcelizim të parcelave në zonën kadastrale Rahovec;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i draft - rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Rahovecit;
9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e Ansamblit Komunal të Këngëve dhe të Valleve në Rahovec;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2023;
11. Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre;
12. Informatë për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit dimëror;

Kryesuesi: A ka dikush prej anëtarëve të kuvendit ndonjë sugjerim rreth rendit të ditës?... Nëse jo, atëherë i kemi edhe dy propozime të tjera shtesë nga ekzekutivi.

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nëkryetar, anëtarë të kuvendit. Bëhet fjalë për dy pika që i kemi pasur në muajin e kaluar (shkurt), që për shkak të ndryshimeve të disa akteve nënligjore është dashur që të kompletohen dhe të përfshihen në preambulë edhe ligjet e tjera që rregullojnë tematikën e ndërtimit. Caktimi i lokacionit në zonën kadastrale në Kramovik dhe caktimi i lokacionit në zonën kadastrale në Polluzhë.

Kryesuesi: Atëherë, kush është “për” përfshirjen e këtyre dy pikave në rend dite?... Me shumicë votash edhe këto dy pika përfshihen në seancën e sotme, për t’u bërë 14 gjithsej. Si të tillë po e vendosim në votim rendin e ditës. Kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet rendi i ditës për sot.

Kryetari: Përshëndetje për kryesuesin e kuvendit, për anëtarët e kuvendit, përfaqësuesit e medieve, LMT- KFOR-i, Paulon – përfaqësuesin e JICA-s, nënkryetarin. Falenderoj kryesuesin që i nderuam në heshtje të gjithë ata që janë vrarë, masakruar dhe të pagjeturit. Kjo nuk ka të bëjë me rendin e ditës, por meqenëse po ka shumë përkrahje “Marshimi për drejtësi” (2 prill) në Prishtinë, që dihet botërisht që krerët e UÇK-së, padrejtësisht mbahen atje dhe do të ishte vlerë dhe njëkohësisht nder që ta përkrahim fuqimisht pa dallim, LAVDI!.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet procesverbali.

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;

Edonë Kryeziu: Përshëndetje i nderuar kryesues, i nderuar kryetar, drejtorë dhe gjithë tjerë të pranishëm në këtë sallë. Dua të flas në emër të banorëve të fshatit Xërxë. Ndërtimi i shkollës fillore është projekt i nevojshëm që nuk duhet lënë anash, por duke e parë buxhetin mëse të vogël dhe punime shumë të ngadalësuar, banorët e këtij fshati frikësohen që ky projekt do të jetë i stërzgjatur. Në lidhje me këtë projekt, i kam disa pyetje për drejtorin. Drejtor, a jeni në dijeni që materiali që është vendosur në oborr e që nuk leviz nga vendi, po e bën të vështirë qarkullimin e nxënësve dhe po e ndalon çdo aktivitet sportiv të shkollës. Pse është e domosdoshme të fillohet një projekt, duke e ditur që nuk ka fonde të mjaftueshme?... A ka monitorues të këtyre kontratave dhe nga kush mund të presim përgjegjësi lidhur me mospërfundimin e këtij projekti në kohën e paraparë?!

Vlora Vuçiterna Çmega: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë! Para disa seancash e kam ngritë çështjen e dyshimeve të punësimeve në shëndetësi dhe arsim. Të njëjtin dyshim e kam përsëri te konkursi që do të jetë këtë muaj. Te konkursi për infermierë, ku keni bërë një ndarje të kandidatëve në bazë të shkollimit profesional. Kërkoni më shumë infermierë me shkollë të mesme sesa me baçelor. A jeni bazuar në ndonjë ligj apo udhëzim administrativ ku u jepet më shumë rëndësi atyre që e kanë të kryer vetëm shkollën e mesme ose këta kandidatë me shkollë të mesme që do të pranohen, i takojnë partisë suaj. Uroj që dyshimi im të mos jetë i saktë.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për kryetarin, ekzekutivin, kolegë asambleistë, medie. Mendoj që ndoshta duhet të vije momenti, që Komuna e Rahovecit, ekzekutivi dhe kryetari, bëhen serioz në punë të mëdha, sepse është një paaftësi totale në menaxhim. E kemi Zonën Ekonomike në Opterushë, është bërë si Kalajë e Rozafatit, e kemi kolektorin kryesor të ujërave të zeza (Hoçë e Madhe – Krushë e Madhe), e kemi Kompleksin Memorial të dëshmorëve në Gradish pa epilog, e kemi rregullimin e përrockës që vazhdon prej Brestocit në Krushë të Madhe, është projekt milionësh dhe është për turp. E kemi kompleksion sportiv tek Epopeja e UÇK-së, të njëjtin epilog e ka. Për mjerim është rruga Xërxë – Rahovec. E keni filluar sheshin, ende pa e filluar mirë, kanë dalë disa probleme me disa prona. Në gropimin e parë e keni dëmtuar gypin kryesor të ujit të pijes. Mburreni për renovim të shpejtë të gypit, nuk është mburrje renovimi i shpejtë, mburrje është mosdëmtimi. Çka do të ndodh me sheshin, a do ta ketë fatin e atyre që i përmenda më herët? Çka do të ndodh me tregun e Rahovecit, a

atë mbetet Rahovecit pa treg? Stadiumi? Kjo definitivisht dëshmon paaftësinë e ekzekutivit për të bërë punë të reja. LDK-ja, në mandatin e kaluar, në asamblë komunale, vazhdimisht ju ka tërhequr vërejtjen për kualifikim të kodeve buxhetore dhe për pasojë të mosdëgjimit të opozitës, ka dalë Raporti i Auditorit i kualifikuar dhe për pasojë nuk keni përfitim të grantit të performancës. Nuk është “marre” t’i thoni qytetarëve që “me falni, kam keqmenaxhuar, nuk kam ditë ta bëj punën siç duhet, raporti i auditorit ka dalë i kualifikuar dhe nuk kemi përfituar prej grantit të performancës”. Definitivisht, ky ekzekutiv nuk di të bëjë më tepër, sesa disa punë të vogla.

Sejfullah Sejfullahu: Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, drejtorë, kolegë. Kam kërkesë, apel, kritikë dhe falënderim. I kemi disa lëndina shumë të bukura në Krushë, që janë pronë e komunës. Problemi qëndron që prej 3-4 fshatrave të tjera, na bijnë shumë mbeturina, e nuk po mund t’i zëmë keqbërësit në këtë rast. Drejtoresha i ka dërguar inspektorët, por prapë njëjtë. Kërkesa ime është të shtohet numri i inspektorëve dhe të ketë inspektime më të shpeshta.

Nerisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë! Kam disa pyetje për drejtorin e urbanizmit. A ka leje ndërtimore nga Zyra e Urbanizmit, Sheshi Qendror i qytetit?... A ka leje nga KEDS-i?... Nga KRU-Gjakova?... A ka projekt detal zbatues ky projekt gjigand. Për këto pyetje të parashtruara, pres përgjigje të dokumentuara.

Abnor Mullabazi: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë, të nderuar asambleistë. Sa i përket pyetjeve për shesh: e kemi pëlqimin e Radoniqit. E kemi edhe zgjidhjen teknike prej KEDS-it. Është vetëm fillimi i punës dhe nuk po i shoh të arsyeshme këto paragjykime. Projekti i sheshit është i buxhetuar dhe ju garantoj të gjithëve që në 2025-tën, do ta përurojmë. Te kanali që është në Brestoc dhe në Krushë të Madhe, është i financuar prej ministrisë në tetor 2022, ndërsa në 2023, ministria nuk e ka paraparë në buxhet këtë projekt. Me të hyrat e komunës, është paraparë në plan të prokurimit të fillojnë procedurat për nënshkrimin e kontratës së re.

Kryetari: Po i përgjigjem Edona Kryeziut: Euroingu është operatori që e ka atë shkollë në Xërxë, është vonuar pak, por kam bindje që do ta përfundojë brenda afatit edhe pse ka plot punë aty, si dhe do ta mbulojmë me buxhet. Shqetësim legjitim i Edonës.

Vlora Vuqitërna, rreth punësimeve në QKMF: është e vertetë që vitete të fundit, universitetet private dhe publike, po prodhojnë shumë infermierë/e me master e bachelor, por është edhe një numër i madh i atyre që kanë shkollë të mesme, por me përvojë të madhe në këto institucione. 28 vende janë të shpallura, 11 prej tyre me fakultet, 17 me të mesme, si infermierë të licencuar. Nevojë kemi edhe për më shumë të tillë, për stomatologë, farmacistë dhe mjekë. Pëmdryshe, Vlora ka të drejtë, ata që janë me fakultet, natyrisht që duhet të kenë përparësi. Sa i përket menaxhimit të projekteve dhe ecurisë së investimeve publike në komunën tonë: është nënshkruar kontrata për Zonën Ekonomike, pikërisht nga presioni i kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale të cilën e kritikove pa bazë pak më herët. Zona Ekonomike ka nisur nga viti 2004, kur ka qenë Esat Haxhijaha (ndjesë pastë) dhe kryeshef Ibrahim Kryeziu, në 2018 është themeluar, në 2021 është licencuar, në 2023 është lidhur kontrata me bashkëfinancim me Ministrinë e Tregtisë dhe Ndërmarrësisë dhe Industrisë, projekti ka vlerë mbi 3 milion. Kolektori i ujërave të zeza dhe trajtimi i shtratit të përroit nga Hoça e Madhe që kalon nëpër Brestoc, Hoçë të Vogël, Nagac e lidhet me Krushë të Madhe, ju e dini që ka qenë i financuar prej Ministrisë së Planikimit Hapësinor dhe Mjedisit dhe është ndërprerë financimi, ka skadar kontrata dhe nuk e ka vazhduar. Jemi duke i shikuar mundësitë për revidimin e projektit. Rruga 4 korsi: Burim Krasniqi nuk ka lënë gur pa lëvizur, duke u munduar ta bllokojë rrugën. Lajm i mirë është që tre operatorët do ta fillojnë punën. Sa i përket Sheshit Qendror dhe defektet që po ndodhin, janë shumë normale gjatë punës, për shkak të atij gabimi të gypi, operatori e ka shkarkuar shoferin dhe e ka lënë pa rrogë. Te tregu i Rahovecit: këtu shihet që Burimi nuk e di se çka përmban Sheshi Qendror. Tregu ditor i mbyllur do të bëhet brenda sheshit dhe është pjesë e paraparë në projekt detal, i cili ekziston. Mund të kemi probleme me prona, sepse jemi në betejë ligjore me AKP-në dhe besojmë që do t’i kalojmë këto sfida. Sheshi do të bëhet, në 2025 do të përfundojë, duhet të ndodhë ndonjë situatë e jashtëzakonshme që punimet të ndërpriten. Tek opinioni i

ZKA-së, për shkak të kualifikimit, ndoshta dikush edhe gëzohet, por çuditërisht nuk janë gëzuar më herët, sepse është viti i 9-të rresht që Komuna e Rahovecit fiton grante. Normalisht, ndihem jomirë kur nuk fitojmë grant, është hera e parë që nuk kemi fituar. Te stadiumi: ju kam thënë që nuk e ka seriozisht ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ku është zotimi për stadium?... A e dini që e kemi “bllokuar” PZHK-në për shkak se jemi duke luftuar për ta gjetur një lokacion, me gjasë te Stone Castle, nuk po na lejojnë, për më tepër, e kanë hequr edhe kodin e buxhetit për stadium. Te lëndinat e Krushës: është e tmerrshme që njerëzit e papërgjegjshëm hedhin mbeturina aty ku nuk e kanë vendin. Mbeturinat vazhdojnë të hidhen, përkundër numrit të madh të gjobave mandatore të shqiptuara. Duhet të mobilizohemi të gjithë dhe së paku t’i raportojmë rastet, një fotografi ose një emër të personit dhe atij do t’i shkojë gjoba me postë. Po përmendet Raporti i Auditorit dhe po përmendet kinse ne jemi fajtorë, por mos harroni që prej atij kodi, që nuk e kanë lejuar më vonë ministria, shumë fermerë kanë përfituar. Te Sheshi Qendror, i kuptojmë pakënaqësitë, por për ta rregulluar një shesh me vlerë 4 milion euro, mund të ketë edhe kufizime, sfida dhe vështirësi.

Kryesuesi: Faleminderit kryetar! Për hir të korrektësisë, meqë u përmend stadiumi dhe punët e mira për interes të përgjithshëm, e ke pasë zotimin tonë për mbështetje çdo herë. Te kodi për çështjen e stadiumit, këtu e kam zotimin publik të ministrit, ku thotë: dua ta përsëris zotimin tonë dhe në momentin që sigurohet lokacioni i përshtatshëm dhe konsensual dhe i njëjti të votohet në Kuvendin e Komunës, do të filloj menjëherë procedurën e hartimit të projektit të stadiumit të qytetit dhe zotohemi për sigurimin e buxhetit.

Kryetari: Në qoftë se ti ke vendosë ta mbrosh postimin e ministrit, shumë në rregull edhe unë jam dakord. Këtu është vetëm një problem, le ta mbajë fjalën ai, le ta zgjerojnë zonën ndërtimore atje (në Pallaticë), duke e futur në PZHK dhe le ta hapin kodin e ri (ata e kanë në dorë dhe jo ne). Por, “nga e thëna në të bërë është një det i tërë” dhe nuk ka nevojë të votohet në Kuvend të Komunës konsensusi për stadium, Kuvendi i Komunës, bisedon për lokacionin e stadiumit.

Burim Krasniqi: Kryetar, mirë e the, diçka që është keq duhet thënë, ashtu siç e the për qeverinë që e ka hequr kodin. Punët e këqija duhet t’i themi, të mirat i përjeton qytetari. Projektet e përmendura, më i riu i ka tre vjet që ka filluar, më i vjetri i ka fiks 19 vjet. Pyeta, sheshi a do ta ketë fatin e këtyre projekteve. Kompleksi sportiv tek Epopeja është projekti më i ri që i ka mbi 3 vjet, ndërsa çështja e zonës industriale i ka 19 vjet. Nëse nuk është kështu si thotë Burimi, atëherë kërkoj falje publikisht, të gjitha janë projekte që kanë mbetur zvarrë. Te çështja e rrugës Xërxë – Rahovec, nuk është e vertetë ajo që tha kryetari “ka bërë luftë Burimi për bllokim”. Në fushatë zgjedhore, publikisht kam thënë që nëse Burimi bëhet Kryetar Komune, ajo rrugë nuk bëhet katër - shiritore dhe prapë qëndrojmë pas saj, duke folur profesionalisht. E treta, secili në një formë ose tjetrën, jemi në pozicionin tonë, a do të qëndrojmë gjatë apo shkurtër në opozitë, e flet qytetari. Kjo gjuhë, ka bërë që raporti i auditorit të jetë i kualifikuar dhe LDK-ja nuk u është kënaqur këtyre gjërave, sepse ka dhënë vërejtje vazhdimisht nëpër mbledhje. Është mirë që gypi është sanuar shpejt, gjithashtu është turp që është prishur. Të jemi të sinqertë, pranoji kritikën e asamblesë, përmirësoji gabimet që janë.

Kryetari: nëse kanë ndodhur rezultatet në Zonën Ekonomike, fatkeqësisht kanë ndodhur vetëm në kohën kur unë kam qenë kryetar, vetëm në atë kohë. Deri në 2018, nuk ka pasur rezultate, në atë kohë është themeluar Zona (28 qershor 2018). Me 28 janar 2021, është licencuar Zona. Sa i përket gypit, nuk është dashur të ndodhte as lufta Rusi – Ukrainë, por ndodhin këto. Këtu, qëllimi nuk ka qenë të priset gypi, por falenderoj kompaninë, nënkryetarin, drejtorin dhe KRU-në, që e kanë sanuar shpejt. Te rruga 4 korsi: keni takuar ministra e kryeministra për ta ndalë rrugën, nuk keni mundur ta ndalni, sepse rruga do të bëhet dhe beteja është që ta rrisim efikasitetin e operatorit në terren.

Burim Krasniqi : një pyetje rreth stadiumit, për hir të opinionit: a është e vertetë që në zyrën tuaj kemi biseduar rreth stadiumit, që mirrni vesh për lokacion dhe 6 votat e LDK-së i keni.

Kryetari: Po, e vertetë! Por, problemi është te statusi i tokës (ndërtimore) dhe ata e kanë në dorë, mund ta bëjnë zgjerimin e zonës ndërtimore dhe të vazhdohet me hapjen e kodit dhe procedura të tjera.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë, media. Po e citoj një thimë të të madhit Faik Konica: “përgjegjësia jonë ndaj vendit është e pamohueshme, do të vuajmë me vuajtjet e Shqipërisë, do të gëzohemi me gëzimet e saj”. Për drejtorin e Shërbimeve publike dhe kryetarin, i kam disa pyetje: Si i përket projekteve, cilat janë të finalizuara dhe cilat në funksion?... Sa janë të papaguar dhe me çfarë përgjegjësie ligjore janë filluar?... Kur do të fillojë ndriçimi publik në Nagac?... Kubëzimi i rrugëve dhe trotuari publik për fshatin Hoçë e Vogël dhe Brestoc?...

Kryetari: “Veç një qëllim i lartë të bën me duru, zemrën ta forcon, në kundërshtime kurrë s’bon me u ligështu e mëtej ai që nuk qëndron”.

Merisa Sharku: Mirë është që po punohet kryetar, jam kurioze te punimet në qendër. Pse po bëhet devijimi i Lumit Duhillo?...

Kryetari: Te sheshi në qendër, po ndodh një devijim i kanalit, sepse ka kundërmuar një erë të keqe të ujërave të zeza. Sheshi në qendër pas datës 15 prill, do të bëhet një shesh shumë i mirë.

Sejfullah Sejfullahu: Kryetari, sot, i personalizoi gjërat aq shumë sa që mendove që jemi në fushatë. Sa i përket lëndinave, a ka mundësi t’i pastroni ato mbeturina?... Sa i përket kolektorit të ujërave të zeza, a ka “qare” pa u bërë njëditë dhe kur?... Përndryshe, mund të vije dita kur ujërat e zeza mund të na ngultafin, në mungesë të kolektorit.

Merisa Sharku: Përgjigja për shpërthim të gypit ishte shumë e mangët, përkundër projektit që nuk është i vogël dhe nuk është shtëpi banimi. Nëse punohet profesionalisht, nuk do të ndodhin këto probleme serioze.

Dilon Mustafa: Atëherë, përshëndetje për kryesuesin, përshëndetje kolegë. Shfryëzoj rastin, që të gjithë besimtarëve t’u uroj Ramazanin. Një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, në lidhje me kubëzimin e rrugëve dhe trotuarin në fshatin Gur i Kuq. Sa i përket Merisë, nuk mund ta kuptoj sesi një profesioniste i kërkon drejtorit a keni dokument të KEDS-it dhe të Radoniqit dhe të njëjtën kohë pyet, pse ka ndodhur defekti. Në përurim të sheshit nuk ke qenë, besoj që aty do të informoheshe me detaje më të sakta.

Albnor Mullabazi: Faleminderit kryesues! Projekti i sheshit është një ndër projektet më madhore që ka pasë ndonjëherë urbanizmi i Komunës së Rahovecit. Defekti ka ndodh dhe përsëri mund të ndodh, javën e ardhshme gypi do të zhvendoset i tëri, bashkë me rrejtin e energjisë. Pavarësisht problemeve dhe sfidave, sheshi do të përfundojë në 2025.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! E kam një kërkesë për anëtarët e kuvendit dhe drejtorët, që të reflektoni në produktivitet të debateve, sepse kemi mbi 40 minuta diskutim për një shpërthim të paqëllimshëm të një gypi dhe besoj që qytetarët e komunës kanë probleme me të mëdha sesa një debat shterp.

Leonard Morina: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Në seancën e muajit të kaluar, e kemi pasë një pikë të rendit të ditës, për një komision që u krijua për intervistimin e drejtorëve të shkollave. Ka qenë një kandidat, që është i pari, Ardit Halilaj, dhe pas ankesës që bëri LDK dhe VV-ja, doli që ky nuk i plotësonte kushtet dhe kjo bëri që kandidati të ndërrohet. Në vend të tij, u bë një drejtoreshë e shkollës dhe sipas udhëzimit administrativ thotë që kandidati i parë duhet të jetë i punësuar në DKA, ndërsa kandidati i dytë mund të jetë drejtor shkolle. Në komision nuk e kemi asnjë të punësuar në DKA. A është i ligjshëm ky komision, apo duhet të ndërrohet përsëri?...

Përparim Krasniqi: Faleminderit kryesues! E falënderoj Paulon për prezencë! Më vije mirë që është këtu, sepse “JICA” japoneze ka ndihmuar shumë komunën e Rahovecit në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke korrur sukses në nivel vendi, duke qenë Komuna e parë në Kosovë që kemi më pak deponi ilegale. Sa i përket pyetjes së Lirigzonit: jemi duke punuar në 4 segmente rrugore në Hoçë të Vogël dhe do t’i përfundojmë punimet shumë

Shejt. Sa i përket ndriçimit në fshatin Nagac, në rrugë kryesore, shpresojmë që nga muaji maj do të bëhet zëvendësimi i poçeve, gjithashtu edhe trutualet janë në kontratë.

Lirigzoni: Rreth kubëzimit të rrugëve që kanë pasur kërkesa, psh: në lagjen “Lezi”, “Krasniqi” dhe “Shala”, a janë të përfshira në këtë projekt dhe kur do të fillojë puna.

Pirparim Krasniqi: Po, Lirigzon, në momentin e përfundimit të rrugës, në të cilën po punohet, do të fillojmë me ligjet e përmendura, sepse janë në kontratë.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për faljen e borxheve të papaguara për taksat në aktivitete (shariste), nga data 1.1.2000– 31.1.2017;

Erhan Morina: Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit. Para jush kemi propozim-vendimin për faljen e borxheve të papaguara për të gjitha bizneset pasive, nga viti 2000, deri më 31 dhjetor 2017. Bëhet fjalë për një listë të bizneseve dhe borgjeve të akumuluar nga 2000-2017. Ky borxh juridikisht konsiderohet si borxh i keq, po ashtu juridikisht, nuk kemi mekanizma për inkasimin e tyre. Vlera e borxhit që propozohet të falet është 346.213 euro dhe përfitojnë 755 biznese. Kërkesa jonë është që ky borxh të falet.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues! Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, në emër të grupit të asambleistëve të LDK-së, e kemi një propozim: këto nuk janë falje të borxheve, por janë borxhe të parashkruara, andaj propozojmë që vendimi të ndryshohet si vijon “ të fshihen borxhet e parashkruara”, sepse nuk mund t’i legalizojmë duke i falur.

Sinan Kryeziu: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë! Kur jemi te propozimi i kolegut nga radhët e LDK-së, mendoj që parashkrimet bëhet nga ana ligjore dhe “të falen borxhet” nuk është perceptim i gabuar, thjesht janë sinonime, fjalë të ndryshme me të njëjtën domethënie “bukë – samun, detyrim – obligim”.

Sejfullah Sejfullahu: Herën e kaluar kur ishte kjo pikë e faljes së borxheve, e ngrita dorën për falje, sepse afarizmi nuk i ka punët mirë. Do të ishte më mirë që faljen e borxheve ta bëni deri më 1 janar 2023.

Burim Krasniqi: LDK-ja nuk e konteston çështjen e shlyerjes së borxheve. E kam një pyetje për Sinanin, këto borxhe a mund të inkasohen ndonjë kohë nga Komuna?... Nëse nuk mund të inkasohen për shkak të parashkrimit, nuk janë falje. Një propozim në KPF, që e kemi dhënë, nuk është këtui.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! E falënderoj drejtorin që i ka sjellë emrat e borxhlinjve! Ndoshta Lirigzoni e ka propozimin me të drejtë, por unë nuk jam jurist dhe jam “për” shlyerjen e këtyre borxheve.

Erhan Morina: Faleminderit Burim për pyetjen! Realisht këto borxhe janë prej vitit 2000. Nëse kishte pasë ndonjë mekanizëm, sigurisht njëri prej drejtorëve para meje do ta trajtonte këtë çështje. Mendoj që Kuvendi mund t’i japë legjitimitet këtij vendimi, përkundër drejtorisë, e cila nuk ka kompetencë ta trajtojë këtë borxh ndryshe.

Hasan Përboqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Ne si grup e përkrahim propozimin e ekzekutivit. Është shumë e vertetë që Komuna, këto borxhe, nuk mund t’i inkasojë dhe është mirë që të falen dhe mos të figurojnë si borxhe.

Kryesuesi: Atëherë e kemi edhe një propozim tjetër që unë si kryesues do ta propozoj si propozim të dytë: në KPF (16 mars 2023), Burimi, ka propozuar që të shtohet një nen në këtë vendim, ku thuhet që bizneset që do ta aktivizojnë statutin e tyre në ARBK, borxhet automatikisht t’i kthehen përsëri.

Erhan Morina: Po, Burimi në KPF ka propozuar që nëse bizneset, gjatë kohës në të ardhmen e aktivizojnë punën e tyre, sërish të ngarkohen me borxh, i cili u është falur. Besoj që nëse dikujt ia falim borxhin sot, nuk do të kishim mundësi për monitorim që ta ngarkojmë përsëri me borxh, nëse ai aktivizon biznesin, thjesht mund të shpeshtohen dilemat dhe tollovitë.

Rasim Fazliu: Edhe një herë të sqarohemi, që të mos bëjmë huti në Kuvend. A prishë punë të futet në përmirësim falia e Lirigzonit dhe ne mos të ndahemi në dysh, qëllimi është të shlyhen borxhet.

Kryesuesi: Atëherë e ftoj zyrtarin ligjor për një interpretim më të qartë.

Mirsad Shala: Faleminderit kryesues! Përsëritet për të gjithë! Në praktikën e kaluar, gjithmonë kemi falur borxhe, sepse në momentin që falen edhe shlyhen dhe definicioni më i saktë është “falja e borxheve”.

Nënkryetari: Përsëritet, i nderuar kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit dhe gjithë të pranishëm. Fjala “parashkrim” nënkupton “vjetërsim”, këtë “vjetërsim” ne po e kthejmë në falje dhe institucioni kompetent për këtë jmi ju.

Burim Krasniqi: Lirigzoni në emër të grupit të LDK-së, nuk tha që jemi kundër faljes së këtyre borxheve. Kërkoj që të shkruhet “falja e borxheve të parashkruara”.

Kryesuesi: Megjithatë, si kryesues, propozimet po i vendos në votim. Atëherë, fillimisht po e vendosim në votim propozimin e Lirigzonit, që në emër të LDK-së ka propozuar që në vend të “faljes së borxheve” të zëvendësohet me “parashkrimin e borxheve”. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë me 2 vota abstenim, 16 kundër dhe 11 “për” nuk kalon propozimi i Lirigzon Kastratit. Në vazhdim, po e vendosim propozimin e Burim Krasniqit prej KPF-së, t’i bashkëngjitet këtij propozim-vendimi një nen ku thuhet që në rast të ndyshimit të statutit të bizneseve, atëherë borxhi që po i falet tash do t’u kthehet. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, nuk kalon propozimi i dalë nga KPF-ja. Po e vendosim në votim pikën e tretë si të tillë. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 19 vota “për”, 5 kundër dhe 2 abstenime, kalon pika e tretë e rendit të ditës. Një lutje për të gjithë anëtarët e kuvendit, që për shkak të prezencës së përfaqësuesve të organizatës japoneze “JICA”, pika e tetë e rendit të ditës, të diskutohet tani, që mos të maltretohen me pritje.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i draft - rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Rahovecit;

Përparim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Komuna e Rahovecit, për herë të parë, po e bën një rregullore të tillë me harmonizim në nivel të Kosovës. Dua ta falënderoj organizatën “JICA”, që ka punuar në këtë drejtim, po ashtu junjoftoj që do të ketë edhe rritje të taksës për mbeturina për amvisëri (6 euro për amvisëri).

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Këto çmime që janë këtu, drejtori është dashur që krahë këtyre t’i vendosë edhe çmimet që kanë qenë deri tani, ta dimë se sa po bëhet ngritja e çmimit. Tani është më lehtë për ne dhe dimë se çka të propozojmë.

Bejtullah Deliu: Faleminderit i nderuar kryesues, të gjithë të pranishmit këtu! Te kolonat këtu që figurojnë bizneset e ndryshme, në bazë të tarifave mujore që janë ndarë, në kolonën e dytë dhe të katërt, figurojnë bastoret dhe kazinot, siç e dimë këto janë të ndaluara me ligj në Kosovë dhe është mirë këto dy terme të hiqen, para se të vendoset në votim.

Përparim Krasniqi: Faleminderit i nderuari Rasim, dallimi është në kontejnerë, në bazë të kategorisë është për zbrazje, nuk do të merret për muaj, por vetëm për zbrazje. Është një rritje, por rritja është shumë e vogël.

Rasim Fazliu: Drejtor i nderuar, po e marr një shembull: tarifat mujore për një kontejner 1.1 metër kub është 46.5 është tarifë mujore? D.m.th, shkolla duhet t’i paguajë 46.5 euro në muaj?

Përparim Krasniqi: Jo, nuk është ashtu. Në fund të tabelës është 12 euro tarifa e zbrazjes, në qoftë se një shkollë nuk gjeneron më shumë se një kontejner, atëherë nuk ka nevojë ta paguajë taksën 46, në qoftë se ka shkolla me vëllim më të madh që i bëjnë 10-15 zbrazje, atëherë mund ta bëjnë një kontratë mujore me kompaninë që çmimi fiks të jetë 46 euro në muaj.

Burim Krasniqi: Drejtor, në kolona të bizneset private, nuk po e shoh askund kategorinë e fabrikave, qoftë pikat grumbulluese të pemëve dhe të perimeve, qoftë fabrikave të plastikës dhe kjo mbetet në vullnetin e lirë të kompanisë se ku dëshirojnë të pozicionohen.

Sejfullah Sejfullahu: Komenti im ka të bëjë me pagat e atyre njerëzve që punojnë në ambient, a janë rritur ato, a janë rritur çmimet për mbeturina.

Erparim Krasniqi: Burim, fabrikat në rregullore do të trajtohen më ndryshe, në mënyrë të veçantë. Sefë, sa u përket pagave, besoj që do të ketë ngritje graduale, edhe pse nuk është kompetencë e jona.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Këto pyetje dhe sugjerime mund t'ua bëjmë edhe komisioneve, sepse i kemi dy komisione të aksionarëve të votuar këtu, për ekoregjion dhe për stacion të autobusëve. Atëherë, nëse nuk ka pyetje tjetra, po e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë me 17 vota “për”, 1 kundër dhe 4 abstenime, miratohet draft - rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Rahovecit. Para se të dalim te pika e katërt, vazhdojmë me një pauzë.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.149/2006, i datës 14.7.2006;

Erhan Morina: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit. Para jush keni propozim-vendimin për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.149/2006, i datës 14.7.2006. Fjala është për parcelën 002666-0 në zonën kadastrale Hoçë e Madhe. Aktualisht, afati ligjor i këtij vendimi ka mbaruar dhe qëllimi i shfuqizimit të këtij vendimi është që pas aprovimit nga kuvendi, ne mundemi ta pastrojmë certifikatën e pronës së shfrytëzuesit të deritanishëm. Në seancën e radhës ta japim në procedurë të rregullt në shfrytëzim përmes ankandit publik.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Në mbledhjen e kaluar i kam premtuar kryetarit, që këtë pikë në mbledhjen e radhës, gjithsesi do ta votojmë, po flas personalisht. I kam disa pyetje për drejtorin: shfrytëzuesi prej vitit 2006 deri në 2016, a keni shënime sa janë obligimet e kryera nga ana e tij dhe sa jo?... Nuk është ky rast i vetëm, kemi pasë edhe në mandatet e kaluara kësi lloj rastesh dhe është mirë që ne si Komunë të jemi më syçelë. Do ta shfuqizojmë duke e votuar këtë pikë edhe pse ligjërisht i ka kaluar afati, kjo i bie njëjtë sikurse “nëse një person ka vdekë në vitin 2016 dhe në 2023 me marrë prapë vendim që ai person ka vdekë”.

Erhan Morina: Faleminderit z. Rasim Fazliu, aktualisht nuk ka obligime ndaj Komunës dhe arsyeja pse ka mbetë deri tani kjo gjendje është sepse pronari nuk ka qenë këtu, është jashtë kufijve të Kosovës.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Atëherë, nëse edhe dikush tjetër nuk ka ndonjë koment, po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë votash, miratohet propozim-vendimi.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-71510057-05539-0 - zona kadastrale Rahovec;

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! Të nderuar Anëtarë të Kuvendit. Në bazë të ligjeve në fuqi, Kryetari i Komunës, ju propozon shpalljen me interes të përgjithshëm publik të parcelës 05539-0 zona kadastrale Rahovec, 100 m² (te pompa e benzinës “Shell”, ana e majtë – rruga Rahovec - Brestoc). Në procedurat e ardhshme, kur dokumentet të marrin ligjshmëri, qëllimi është të marrim pëlqim për këmbim të parcelës në fjalë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. Atëherë nëse edhe dikush tjetër nuk ka ndonjë koment, po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë unanime, miratohet edhe pika e pestë.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike me pronën e Institucionit Qendror – zona kadastrale Rahovec;

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! Sipas ligjeve në fuqi, Kryetari i Komunës, i propozon KPF-së dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike me Institucionin Qendror – zona kadastrale Rahovec. Bëhet fjalë për dy parcela, një është mbi shkollën fillore “Bekim Sylka” (22 ari e 61m²), kjo parcelë të këmbëhet (do t'i jepet Komunës) me një parcelë të Komunës, e cila gjendet në zonën kadastrale në Rahovec (Rahovec – Drenoc, në sipërfaqe prej 1ha 9 ari e 77m², e cila i jepet në posedim Agjencionit Pyjor të Kosovës.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Atëherë, nëse edhe dikush tjetër nuk ka ndonjë koment, po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë votash, miratohet edhe pika e gjashtë.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për riparcelizim të parcelave në zonën kadastrale Rahovec;
Afrim Oruqi: Sipas legjislacionit në fuqi, Kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit miratimin e vendimit për riparcelizimin e parcelave kadastrale, bëhet fjalë për parcelën priavate, e cila gjendet në pjesën që fatmirësisht ka filluar të ndërtohet sheshi qendror i qytetit. Parcela është në pronësi të pronarëve privat: Hajrullah Bahjtar Dula, Tsim Bahjtar Dula dhe Hysnije Sefer Dula, me sipërfaqe prej 8 ari e 28m². Ky riparcelizim nënkupton drejtimin e parcelës në atë kahje që nuk do të ishte pengesë për projektin e sheshit, duke u kthyer drejtimi i parcelës në drejtim të stadiumit.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Atëherë, nëse dikush nuk ka ndonjë koment, po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë unanime, aprovohet edhe pika e shtatë.

9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e Ansambilit Komunal të Këngëve dhe të Valleve në Rahovec;

Kryetari: Ideja është që me vendim të Kuvendit të Komunës, të themelohet Ansambli Komunal i Këngëve dhe i Valleve në Rahovec, pastaj do ta formojmë një grup punues, i cili do ta hartojë propozim – statutin.

Sejfullah Sejfullahu: Nuk kam diçka të veçantë, vetëm e përshëndes këtë iniciativë nga këndi i një artdashësi dhe si një pjesëmarrës i rregullt i ansambleve dhe i aktiviteteve kulturore.

Kryesuesi: Faleminderit! Dikush tjetër ndonjë koment?... Atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë unanime, miratohet propozimi për themelimin e Ansambilit Komunal të Këngëve dhe të Valleve në Rahovec.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2023;

Kryesuesi: Plani i punës është votuar fillimisht nga anëtarët e këshillit të fshatit, formalisht duhet të kalojë edhe të miratohet nga kuvendi. Kush është “për”?... Me shumicë votash, miratohet edhe Plani i Punës së Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2023.

11. Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre;

Afrim Oruqi: Të nderuar kuvendarë, sipas Planit të Punës të Kuvendit, parashihet që brenda vitit të raportojmë lidhur me pronat komunale dhe menaxhimin e tyre. Para jush, e keni një informatë me listën e pronave, bëhet fjalë për 34 zona komunale.

Burim Krasniqi: Te pronat publike, sidomos ato që janë me rëndësi, nëse ka ndonjë pronë që nuk ka vendim për shpallje me interes të përgjithshëm, a ekziston mundësia që të pamundësohet procesi i tjetërsimit të pronave, nga njerëzit që kanë tendencë t’i marrin ato?... Të inkurajoj që në një seancë të radhës, të na vije vendim me një listë të pronave që t’i mbrojmë për të ardhmen.

Afrim Oruqi: Me kërkesë të Kryetarit, në mandatin e kaluar, kemi punuar shumë me gjeodetë, duke i identifikuar të gjitha parcelat komunale dhe i kemi vendosur në Kuvend për t’i shpallur me interes të përgjithshëm. Pastaj, MAPL-ja, na ka rekomanduar që nuk ka nevojë t’i shpallim me interes të përgjithshëm pronat, apo parcelat që janë komunale.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Atëherë, nëse edhe dikush tjetër nuk ka ndonjë koment, po e kalojmë pikën e njëmbëdhjetë.

12. Informatë për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit dimëror;

Përparim Krasniqi: Sivjet ka qenë një kohë mjaft e mirë dhe nuk ka pasë ngrica, mirëpo për shkak të planit që ka qenë në kuvend, e kemi obligim ligjor të raportojmë. Komuna e Rahovecit, i posedon tri kompani të kontraktuara për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë dy sezonëve, tani jemi në sezonin veror, sepse perioda dimrore llogaritet 15 nëntor – 15 mars. Nuk do të vazhdoj në detaje, por këtu jam për sqarime shtesë.

Burim Krasniqi: Ndërkohë kur të jepet mundësia, a mund të na dërgosh një informatë të gjithë asambleistave se sa janë realizuar kontratat sipas loteve që janë në sezonin dimrore.

Lirigzon Kastrati: Drejtor, sa i përket rrugës rajonale, desha ta ngrisë një çështje për diskutim d.m.th. Rahovec – Krushë. Kjo rrugë, në vitin e kaluar, aspak nuk është mirëmbajtur, a pritet që këtë vit do ta trajtoni këtë çështje me shumë seriozitet?... Tjetër, në kontrata, a përfshihet vetëm në rrugë, apo edhe brenda vendbanimeve pastrimi i rrugëve?...

Përparim Krasniqi: Burim, për seancën tjetër mund ta jap edhe raportin me shkrim. Sidoqoftë, në bazë të specifikacionit që kryen operatori, ne kemi raport mujor në kontrata me ta. Sa i përket pyetjes së Lirigzonit, rruga rajonale është kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe aty nuk kemi asnjë lloj të kompetencave.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Atëherë, nëse edhe dikush tjetër nuk ka ndonjë koment, po e kalojmë pikën e dymbëdhjetë.

13. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndyshme kulturore në fshatin Kramovik;

Afrim Oruqi: Bëhet fjalë për pikën e njëjtë që e kemi pasë muajin e kaluar në Kuvend, për parcelën nr. 330-3 (77 ari e 68 metra katror dhe ne po vendosim që brenda kësaj parcele të ndajmë 4 ari). MAPL-ja ka kërkuar nga ne që të përcaktohet saktë lokacioni me parcelë dhe koordinata se ku planifikohet të ndërtohet ky objekt. Pa vendim të Kuvendit nuk kemi guxuar ta ndajmë parcelën, uroj që të kalojë.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Dikush tjetër ndonjë pyetje?... Atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e trembëdhjetë e rendit të ditës.

14. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndyshme kulturore në fshatin Polluzhë;

Afrim Oruqi: Bëhet fjalë për zonë kadastrale në Polluzhë, parcela me nr.722-0, kërkesa e komunitetit është që të ndahen dy ari prej kësaj sipërfaqeje, që të ndërtohet një objekt për nevoja kulturore.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Dikush tjetër ndonjë gjë?... Atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet edhe pika e fundit e rendit të ditës. Çdo të mirë dhe mirëmbetshi!

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I

Defrim Kafexhiu



REPUBLIKA E
KOSOVËS

STACIONI I AUTOBUSAVE



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu



Nr. prot : 31/23

-III- Nr. I prot. 1457 Më 07.04.2023
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

**RAPORTI FINANCIAR BUXHETOR I
NPL – STACIONI AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A**

PËR PERIUDHËN 1 JANAR – 31 DHJETOR 2022 RAPORTI VJETOR PËR VITIN
2022 ËSHTË PËRGATITUR BAZUAR NË LIGJIN NR. 03/L-087, MBI
MENAXHIMIN E FINANCEVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

- Informata të përgjithëshme..... 3.
- Përmbledhje Ekzekutive 4.
- Prezantimi 5.
- Pasqyra e strukturës organizative 6.
- Financat..... 8.
- Hyrjet dhe Shpenzimet 9.
- Humbje dhe Fitimi 14.
- Obligimi ndaj të gjithë palëve 15.
- Një mbishkrim mbi Ndërmarrjen..... 16.



REPUBLIKA E
KOSOVËS

STACIONI I AUTOBUSAVE



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

1. Informatat e Përgjithshme

Emri i Ndërmarrjes :	Ndërmarrja Publike lokale Stacioni i Autobusëve Rahovec Sh.A
Pronar :	Kuvendi Komunal
Komisioni i Aksionerëve:	Perparim Krasniqi Eqrem Spahiu Merisa Sharku
Bordi i Drejtorëve :	Erlira Mullabazi Habib Shehu Myvlide Kafexhiu Fidan Gashi u.d Kryeshefi Ekzekutiv, Behar Gashi
Buxheti i Planifikuar 2022 :	47,520.00 €
Të Hyrat e 2022 :	44,763.97 €
Shpenzimet 2022:	44,373.28 €
Numri i Peronave	5
Numri i punëtoreve	8
Bilanci Gjitor	M- 6 / F- 2



REPUBLIKA E
KOSOVËS

STACIONI I AUTOBUSAVE



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

2.Permbledhja Ekzekutive

Stacioni i Autobusëve në Rahovec punën e ka filluar si njësi punuese në vitin 1979 në kuadër të Ndërmarrjes për transport të udhëtareve dhe mallrave »Kosovatrans« me seli në Prizren , ku pastaj është shndërruar dhe themeluar si “Ndërmarrje Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Rahovec Sh.A” me datën 13.08.2020.

Karakteri i veprimtarisë ka qenë shërbyese me të gjitha elementet faktike dhe juridike të cilën edhe sot e kësaj dite e kryen me plotë sukses.

NPL - Stacioni i Autobusëve në Rahovec ka objektin prej 294m² dhe Restorantin 157.25m² me lokale përcjellëse: si salla e udhëtareve (pritjes), zyrave të administratës, sporteleve, nyje sanitare.

Mbrenda rrethojave stacioni ka pistën (trasën), peronat për kyqjen operatoreve për linjat sipas rendit të udhëtimit në relacione të ndryshme në sipërfaqe prej (1200m²), gjithashtu ka një sipërfaqe (lulishte) prej 160m² dhe një sipërfaqe prej 1,288m² mbrapa objektit.

Stacioni i Autobusëve e ushtron veprimtarinë shërbyese në ngastrën kadastrale nr.1789-2, Pasuri Komunale nga e cila ngastrë ju është dhënë sipërfaqja prej 48150.0m².

Bazuar në skemën organizative gjatë vitit 2022 kanë qenë të punësuar 8 punëtorë, prej tyre 6 meshkuj dhe 2 femra me një moshe mesatare prej 45.21 vitesh.

Struktura organizative e ndërmarrjes është e ndarë në tetë (2), departamente-sektorë: Administrata dhe Inkasimi.

Burimet kryesore të hyrave janë, shërbimi i perionizimit (pranimi dhe përcjellja e autobusëve),



REPUBLIKA E
KOSOVËS

STACIONI I AUTOBUSAVE



RAHOVEC



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

3. Prezantimi

Ky raport vjetor bazohet ne Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike nr. 03-L-087, nenin 31, pika 31.3, ku qarte përshkruhet se, brenda 45 ditëve pas përfundimit te çdo viti kalendarik, zyrtaret e NP-ve, ne përputhje me Nenin 14.1, do te përgatisin dhe dorëzojnë Bordit te Drejtoreve te NP-se, një raport vjetor për vitin kalendarik te sapo përfunduar, ne te cilin përshkruhen veprimet e marra.

Rezultatet financiare te arritura si dhe efektshmeria e përgjithshme ne realizimin e cazeve te vendosura ne Planin e Biznesit.

Prandaj bazuar ne detyrimet dhe përgjegjshmëritë te cilat rrjedhin nga ligji mbi ndërmarrjet publike ky raport prezanton ne mënyre te qarte te gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e menaxhmentit te ndërmarrjes ne realizimin e objektivave te parashtruara gjate vitit te kaluar, respektivisht vitit 2021.

Ky raport do te prezantoje strukturën organizative te ndërmarrjes, e cila pjese paraqet pjesën me te vlefshme te ndërmarrjes, ku dihet qe, burimet njerëzore janë aset kryesor i çdo ndërmarrjes, sepse pa këto burime shume vështire do te mund te realizohen te gjitha synimet e planifikuara respektivisht, objektivat e planifikuara me qellim qe ndërmarrja te ketë suksesin e synuar.

Performanca afariste dhe financiare e ndërmarrjes janë dy parakushtet kryesore lidhur me suksesin e gjithmbarshëm te ndërmarrjes. Prandaj edhe kjo pjese do te paraqitet ne mënyre te detajuar lidhur me te gjitha informacionet sa i përket te hyrave, shpenzimeve dhe bilancin përfundimtar te sukses gjate vitit 2022.



REPUBLIKA E
KOSOVËS

STACIONI I AUTOBUSAVE



RAHOVEC



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

4.Pasqyra e Strukturës Organizative e Ndërmarrjes

Komisioni i Aksionareve, është organi më i lartë që mbikëqyr punën e ndërmarrjes përmes mekanizmave të zgjedhur për funksionim sa më të mirë dhe angazhohet me kontributin e tij me takime **1(një)** herë në 3 muaj.

Bordi i Drejtorëve si organ më i lartë pas Komisionit të Aksionerëve, mban takime të rregullta **1(një)** herë në muaj dhe sipas nevojës Drejtoret e Bordit vizitojnë here pas here dhe në mënyre rigoroze punën e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Zyrtareve. Kontributi i Bordit të Drejtorëve në këtë planifikim buxhetor është i jashtëzakonshëm me vërejtje dhe sugjerimi.


Veprimtaria shërbyese në lëmin e transportit rrugor të udhëtareve ka karakteristika e veta sepse lëvizja e pasagjereve dhe operatoreve ekonomik është ofertë jo konstante(fikse),por relative e cila kërkon një përkushtim dhe qasje specifike në mënyre që parashikimi të jetë më sa më i drejtë.

Gjate vitit 2022 kane qene te punësuar 8 punëtore, prej tyre, 6 meshkuj dhe 2 femra me një moshe mesatare prej 45.21 vitesh duke mos e përmbushur skemën organizative të ndërmarrjes sipas ligjit ne fuqi.

Struktura organizative e ndërmarrjes - Organogrami është paraqitur më poshtë



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A





NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

4.Financat

NPL "Stacioni i Autobusëve Rahovec" sh.a, krijon te hyrat nga shërbimet e ndryshme te ofruara me statutin e ndërmarrjes:

Shërbimi i perionizimit - ky shërbim paguhet nga te gjithë auto transportuesit e regjistruar ne Kosove te cilët kane linja te regjistruara dhe te lejuara nga Ministria e infrastrukturës (MI), për linjat urbane, nder-urbane dhe ndërkombëtare. Çmimorja për këtë shërbim caktohet nga Komisioni i Aksionerëve, Kuvendit Komunal dhe Bordi i Drejtoreve te ndërmarrjes ne marrëveshje me shoqatën e autotransporteve te Kosovës dhe me miratim te departamentit përgjegjës ne kuadër te MI-se, kjo çmimoren aktuale parashihet te rritet.

Shërbimi i parkingut - Ndërmarrja posedon një hapësire e cila shfrytëzohet për parking te veturave private si dhe autobusëve te ndryshëm dhe pse hapësira është e vogël.

Lëshimi I hapësirave afariste me qira - ndërmarrja ne kuadër te hapësirës se saj posedon 2 lokale te cilat një prej tyre gjate këtij vitit është lëshuar me qira dhe gjate vitit 2023 pritet te lëshohet dhe lokali tjetër.

Me qellim qe ndërmarrja te jete funksionale ka kosto - shpenzime lidhur me paga dhe mëditje për punëtorë, përfshire dhe shpenzimet për paga dhe mëditje për anëtarët e bordit si dhe zyrtarët e larte te ndërmarrjes. Gjithashtu, janë te evidentuara edhe shpenzimet operacionale dhe ato administrative si dhe shpenzimet e amortizimit te ndërtesës se ndërmarrjes dhe pajisjeve te ndryshme me te cilat funksionon ndërmarrja.



REPUBLIKA E
KOSOVËS



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

➤ Hyrje (Performanca Buxhetore)

Performanca buxhetore ka arritur në 44,763.97 € - gjatë vitit 2022, apo 5.88% më shumë krahasuar me te hyrat e realizuara gjatë së njëjtës periudhë të vitit paraprak.

Performanca buxhetore kryesisht është arritur nga peronizimi i operatoreve ku prej tyre është shënuar vlerën prej 41,215.50 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 92.07% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetit për këtë kategori në këtë periudhë.

Performanca nga parkingut ka arritur vlerën prej 2.708.00 €, që vlerën e përgjithshme të buxhetit për këtë kategori në këtë periudhë 6.04%.

Performanca nga parkingut të makinave ka arritur vlerën prej 428.50 €, që vlerën e përgjithshme të buxhetit për këtë kategori në këtë periudhë 0.96%.

Performanca te hyrjes nga qiraja janë inkasuar janë 101.62 €, që vlerën e përgjithshme të buxhetit për këtë kategori në këtë periudhë 0.22%.

Performanca te hyrjes nga Tualeti kane arritur shumen 310.35 €, që vlerën e përgjithshme të buxhetit për këtë kategori në këtë periudhë 0.70%.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

Të hyrat e realizuara nga këto aktivitete të ndërmarrjes janë të paraqitura në tabelën vijues :

Përshkrimi	Viti – 2021	Viti – 2022
Shërbimi i Perionizimit	39,881.00 €	41.215.50 €
Shërbimi i Parkingut te Autobusëve	1,954.00 €	2,708.00 €
Shërbimi i Parkingut te Makinave	443.50 €	428,50 €
Qiraja nga Lokali		101,62 €
Tualeti		310.35 €
Të Hyrat nga Subvencionimi		
TOTALI i Të Hyrave	42.278.50 €	44,763.97 €

➤ Kategoritë e Shpenzimeve

Shpenzimet e përgjithshme janë të ndara në kategorinë e shpenzimeve për:

- Paga;
- Shpenzime operative;
- Shpenzimet administrative;



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

➤ Shpenzime për Paga

Sa i përket shpenzimeve lidhur me paga ne kuadër te ndërmarrjes njihen këto kategori:

- Kompensimi me pagë anëtarët e Bordit të Drejtoreve;
- Kompensimi me pagë zyrtarët e lartë;
- Kompensimi me pagë për punëtorët e ndërmarrjes.

Kompensimi për paga po behet sipas vendimit te bordit dhe paguhen ne baze te kontratave te punës valide te tyre sipas te cilave behet llogaritja e pagës, këtë vit është zvogëluar shpenzimi i pagës nga vitit paraprak prej 20 %.

‘Ndërmarrja Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Rahovec Sh.A’ nuk është duke respektuar Ligjin e punës dhe nuk i paguan:

- Përvoja e viteve te punësimit ne baze vjetore ku behet përlllogaritja nga 0.5% mbi pagën baze, për çdo vit te punës.
- Punëtorët te cilët punojnë gjate ndërrimit te natës dhe ditëve te vikendit i behet përlllogaritja 30% shtese
- Ditët e punës gjate festave zyrtare te Republikës se Kosovës përlllogariten prej 50% shtese



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

Pagat	Viti – 2021	Viti – 2022
Bordi	9,104.64€	7,124.88€
Zyrtar të Lart	8,767.25€	7,517.80€
Stafi i NPL-së	16,582.04€	14,339.76€
Kontabilisti	590 €	550 €
TOTALI	35,043.93 €	29,532.44 €
Borgjet të Pagave	-3100.61	-5,650.00 €

➤ Shpenzime Operative

Ne shpenzimet operative bëjnë pjese te gjitha shpenzimet qe ndërlidhen me funksionalizimin e mirëfillte te ndërmarrjes. Ne këtë kategori bëjnë pjese shpenzimet e rrymës, shpenzimet e ujit, shpenzimet e mirëmbajtjes, shpenzime për mirëmbajtje, si dhe shpenzime tjera te paraqitura detajesh ne tabelën e mëposhtme.

➤ Shpenzime Administrative

Shpenzimet administrative i përkasin shpenzimeve qe lidhen direkt me funksionalizimin administrativ te ndërmarrjes. Ne këto shpenzime hyjnë shpenzimet lidhur me, materiali për zyre, shpenzime te Ndryshme etj.



REPUBLIKA E
KOSOVËS

STACIONI I AUTOBUSAVE



RAHOVEC



KOMUNA E
RAHOVECIT

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

